



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor
Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr. 78
Prishtinë, më 20.9.2016, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj, Armend Zemaj, Valdete Bajrami dhe Milena Miliqeviç.

Mungoi: Agim Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ardian Zullufi, Rrokum TV; Egzon Pacolli dhe Granit Berisha, praktikantë; Ardian Nikolla, gazeta “Zëri”; Sanie Jusufi, gazeta “Koha ditore”; Alma Tafarshiku, EULEX; Agnesa Haxhiu, KDI; Liridona Xhemajli, RTV-21.

Stafi mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci, Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i propozimeve për anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga shoqëria civile;
3. Diskutim për planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i propozimeve për anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga shoqëria civile

Kryetarja, tha se Këshilli Prokurorial ka shpallur konkursin për anëtarin që vije nga shoqëria civile, në përputhje me ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Më tej, znj. Haxhiu shtoi se nga Komisioni për Legjislacion kërkohet të shqyrtojë këto propozime, që në këtë rast, janë katër, ndërsa vetëm tri prej katër propozimeve i plotësojnë kriteret e parapara në Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Më tej, deputetja Haxhiu lexoi emrat e kandidatëve: Naim Krasniqi, Ilir Dukolli dhe Shemsi Jashari, ndërsa Hajrullah Mustafa, meqenëse nuk ka paraqitur pesë organizata të shoqërisë civile që e mbështesin nominimin e tij, konsiderohet se nuk ka plotësuar kushtet e konkursit, tha mes tjerash deputetja Haxhiu. Meqenëse Këshilli Prokurorial ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve, Komisioni nuk ka të drejtë të intervistojë këta kandidatë, theksoi deputetja Haxhiu.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohen Kuvendit që t'i votojë kandidatët për anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës, si në vijim:

- I. Për pozitën e anëtarit nga shoqëria civile, propozohen:
 1. Shemsi Jashari,
 2. Ilir Dukolli,
 3. Naim Krasniqi.
- II. Kuvendi, prej 3 (tre) kandidatëve të propozuar për anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës, do të zgjedhë njërin nga kandidatët e propozuar.
- III. Votimi i kandidatëve për anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës, bëhet me votim të fshehtë.
- IV. Mandati i anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës është 5 (pesë) vjet.

3. Diskutim për planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor

Kryetarja njoftoi anëtarët e Komisionit se organizata GAP dhe NDI kanë propozuar që në planin e punës të shtohet edhe pika e cila ka të bëjë me shqyrtimin e buxhetit për vitin 2017, për institucionet të cilat bien në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion. Pra, në kohën kur

ndahet buxheti për këto institucione, Komisioni të shqyrtojë këto ndarje dhe të bëhen sugjerime nga Komisioni, potencoi znj. Haxhiu. Më tej, ajo shtoi se duke iu referuar pikës 2 (dy), në muajin shtator, në planin e punës, parashihet formimi i grupit të punës për monitorimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, sepse duhet që patjetër të bëhet monitorimi i këtyre ligjeve. Po ashtu, shtoi se Nënkomisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, të cilin e udhëheq deputetja Valdete Bajrami, është mirë ky grup të monitorojë Ligjin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, kur dihet se ka shumë kritika të adresuara në këtë agjenci. Ajo, mes tjerash, shtoi se në plan të punës është paraparë edhe Ligji për procedurën përmbartimore, por meqë ky ligj është proceduar për plotësim-ndryshim, nuk ka nevojë për monitorim. Gjithashtu, përmendi edhe mbikëqyrjen e Ligjit për ndihmë juridike falas. Në fund, deputetja Haxhiu ftoi anëtarët e Komisionit, që të deklarohen për këtë pikë të rendit të ditës.

Selvije Halimi, tha se meqenëse është koha e dëgjimeve buxhetore për vitin 2017, si komision duhet të vazhdojmë të punojmë në këtë çështje, ndërsa sa i përket Agjencisë Kundër Korrupsionit, gjatë javës pritet të bëhet pranim-dorëzimi i drejtorit të ri dhe sigurisht që duhet t'i jepet mbështetje edhe nga Komisioni dhe po ashtu edhe nga Kuvendi, si dhe natyrisht do të shikohet se ku qëndrojnë problemet, sa i përket zbatimit të ligjeve, të cilat bien në fushëveprimin e agjencisë. Deputetja Halimi, më tej rekomandoi që për punët, të cilat Komisioni kishte mbetur mbrapa në sesionin e kaluar, të futen në planin e punës në këtë sesion, në mënyrë që të realizohen me përpikëri.

Armend Zemaj, tha se është koha që të rritet dinamika e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, po ashtu edhe në hartimin e legjislacionit. Komisioni ka arritur të bëjë mbështetje buxhetore për institucionet që vijnë nga fusha e drejtësisë. Gjithashtu, është formuar edhe grupi i punës, i cili në mënyrë intensive ka punuar në pikat ku mund të arrihet kjo mbështetje, pra në kohën kur ishte rishikimi i buxhetit, shtoi z. Zemaj. Më pas, deputeti Armend Zemaj, tha se ajo çka ka mbetur të mbështetet, është implementimi i Ligjit për ndihmë juridike falas, krijimi i zyrave në Gjakovë dhe Ferizaj, dhe me theks të veçantë, përmendi implementimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës. Ndërsa, sa i përket mbikëqyrjes së Agjencisë Kundër Korrupsionit, është plotësuar grupi i punës, ku duhet të punohet në planin e veprimit. Po ashtu, z. Zemaj kërkoi nga kryesuesja e grupit të punës, znj. Valdete Bajrami, që të caktojë kohën, në mënyrë që si grup të fokusohemi në vizitat dhe shqyrtimet e raporteve të punës, që kanë ndërlidhje me vetë ligjin.

Valdete Bajrami, theksoi se meqenëse drejtori i ri do të fillojë punën në fund të muajit, grupi i punës do të ketë takim së shpejti dhe do të vendoset se si do të veprojmë më tutje.

Albulena Haxhiu, tha se do të ishte mirë që në muajin tetor të fillojë mbikëqyrja buxhetore, meqenëse muaji tetor është muaji kur edhe vjen buxheti dhe kur dihet se këtë vit nuk janë përkrahur amendamentet e Komisionit për Legjislacion, nuk janë realizuar synimet që Komisioni kishte. Ndërsa, sa i përket Ligjit për deklarim të pasurisë, është formuar një grup i punës në sesionin e kaluar, mirëpo nuk është bërë asgjë në atë drejtim, prandaj propozoj që t'i bartet kjo kompetencë grupit të punës për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Pra, pas mbikëqyrjes së Ligjit të agjencisë, të mbikëqyret edhe Ligji për konfliktin e interesit dhe Ligji për deklarimin e pasurisë, nënvizoi deputetja Haxhiu. Ajo, mes tjerash, foli edhe për Ligjin për provim të jurisprudencës, ku shtoi se në muajin nëntor do të procedohet për në Kuvend projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për provimin e jurisprudencës, dhe për këtë arsye, nuk ka nevojë që të mbikëqyret, theksoi ajo. Në fund, kryetarja foli edhe për formimin e grupeve të punues, ku tha se meqenëse të dy ligjet kanë natyrë të njëjtë, propozoi që të formohet

një grup, i cili mbikëqyrë të dy ligjet, atë për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit të punës për mbikëqyrjen Ligjit 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L -033, dhe Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L -035.

1. Formohet grupi i punës për mbikëqyrjen e ligjeve, në përbërje:

Armend Zemaj, kryesues;
Albulena Haxhiu, anëtare;
Selvije Halimi, anëtare;
Valdete Bajrami, anëtare, dhe
Milena Miliqeviç, anëtare.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu